



Bruksel, 18.12.2015
COM (2015) 906 final

**RAPORTI NGA KOMISIONI PËR PARALAMENTIN DHE KËSHILLIN
EVROPIAN**

**Raporti i tretë i progresit të Kosovës * mbi plotësimin e kërkesave të
udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave**

{SWD(2015) 706 final}

SHQ

SHQ

* Ky denominim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Opinionin e GJND-së për deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

1. HYRJE

Komisioni Evropian ka nisur dialogun për liberalizimin e vizave me Kosovën * më 19 janar 2012. Më 14 qershor 2012, Komisioni Evropian i ka dorëzuar qeverisë së Kosovës udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave. Ky dokument ka identifikuar të gjithë legjislacionin dhe masat tjera që Kosova duhet të miratoj dhe zbatoj në mënyrë që të avancojë drejt liberalizimit të vizave.

Komisioni ka miratuar dy raporte mbi progresin e Kosovës në dialogun për viza: raportin e parë më 8 shkurt 2013;¹ ndërsa raportin e dytë më 24 korrik 2014.² Këto raporte përmbajnë një vlerësim të progresit të arritur nga Kosova, rekomandimet për autoritetet e Kosovës dhe të dhënat statistikore në lidhje me ndikimet e pritura migruese dhe të sigurisë nga regjimi pa viza.

Ky është raporti i tretë që paraqet vlerësimin e Komisionit mbi progresin e Kosovës në plotësimin e kërkesave të udhërrëfyesit për viza. Ai përmbledh zhvillimet relevante në lidhje me zbatimin e legjislacionit dhe formulon rekomandimet në fushat ku nevojiten hapa të mëtejshëm për përmbushjen e plotë të kërkesave të udhërrëfyesit për viza. Ky raport shoqërohet nga një Dokument Pune i Stafit të Komisionit,³ i cili adreson ndikimet e pritura mbi sigurinë dhe migrimin nga liberalizimi i vizave.

Raporti dhe dokumenti përcjellës bazohen në raportet e dërguara nga qeveria e Kosovës, raportet e hartuara nga ekspertët e Shteteve Anëtare që kanë marrë pjesë në misionin vlerësues në korrik të vitit 2015, informacionet e marra nga Zyra e BE-së në Kosovë, EULEX-i dhe agjencitë e BE-së, si dhe të dhënat statistikore të përpiluara nga Eurostat dhe të paraqitura nga Shtetet Anëtare.

Dialogu i vizave zhvillohet pa paragjykuar pozicionin e Shteteve Anëtare të BE-së ndaj statusit.

2. KËRKESAT E NDËRLIDHURA ME RI-PRANIMIN DHE RI-INTEGRIMIN

2.1. Ri-pranimi

Kosova ka plotësuar të gjitha shtatë kërkesat në fushën e ri-pranimit.

Kosova ka kornizën ligjore mbi ri-pranimin. Ajo ka nënshkruar marrëveshje të ri-pranimit me 17 Shtete Anëtare të BE-së, 3 Shtete Anëtare të Zonës Shengen dhe 2 shtete të Ballkanit Perëndimor.⁴ Kosova ka nënshkruar marrëveshjen e ri-pranimit me Turqinë më 15 dhjetor 2015 dhe ka nisur negociatat me shtetet tjera.

Ripranimi i qytetarëve të Kosovës funksionon mirë, duke përfshirë edhe personat e margjinalizuar.⁵ Kosova ka përmirësuar përpunimin e kërkesave; rastet e pazgjidhura nuk përbejnë më një shqetësim. Nuk ka të dhëna për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi.

¹ COM (2013) 66 final

² COM(2014) 488

³ SWD(2015) 706

⁴ Shqipëria, Austria, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Italia, Lihtenshtajni, Malta, Mali i Zi, Norvegjia, Sllovenia, Suedia, Zvicra plus një marrëveshje e vetme që mbulon Belgjikën, Luksemburgun dhe Holandën

⁵ Gjatë krizës së migrimit të jashtëzakonshëm nga Kosovë ndërmjet muajit shtator të vitit 2014 dhe muajit prill të vitit 2015, 87,495 qytetarë të Kosovës kërkuan azil në Shtetet Anëtare të BE-së dhe Shtetet Anëtare të Zonës Shengen. Në dhjetë muajt e parë të vitit 2015, Kosova ka ri-pranuar 9,182 të qytetarëve të saj.

2.2 Ri-integrimi

Kosova ka plotësuar **dy nga tri kërkesat** në fushën e ri-integrimit.

Buxheti i Kosovës ka alokuar 3.2 milionë Euro për Fondin e Ri-integrimit në vitin 2015, duke përfshirë 1 milionë Euro për ndërtimin e akomodimit për të kthyerit. 20 % e këtij buxheti është shpenzuar gjatë gjysmës së parë të këtij viti. Është krijuar sistemi për menaxhimin e rasteve, i cili lehtëson qasjen e të kthyerve në shërbimet e ri-integrimit. Data e caktuar për kualifikueshmëri mbetet ende korriku i vitit 2010, por edhe ata që janë larguar nga Kosova pas kësaj date mund të përfitojnë pas kthimit nga ofrimi i shërbimeve emergjente, si transporti, strehimi dhe ndihma mjekësore. Individët e cenueshëm përfitojnë nga një varg i tërë i shërbimeve të financuara nga ky fond, pavarësisht datës së nisjes së tyre nga Kosova.

Në gjysmën e parë të vitit 2015, 1,542 nga 2,744 e të kthyerve janë regjistruar në sistemin për menaxhimin e rasteve (56%), dhe pas kthimit në Kosovë kanë marr ndihmë të menjëhershme, siç është transporti, strehimi, ushqimi dhe asistenca mjekësore; 256 persona nga të regjistruarit në sistem (9%) kanë përfituar nga shërbimet e "qëndrueshme" të riintegrimit, siç është asistenca për punëkërkesit dhe mbështetja për planet e biznesit. Programet e trajnimit për të kthyerit e aftësuar dhe riintegrimi i fëmijëve në sistemin shkollor, veçanërisht nëpërmjet trajnimit gjuhësor, duhet të zhvillohet edhe më tej.

Rekomandimi Nr. 1:

- Në mënyrë që të përmbushen plotësisht kërkesat në fushën e ri-integrimit, Fondi i Ri-integrimit duhet të disbursohet plotësisht, me fokus në ofrimin e asistencës me punësim, themelimin e bizneseve të vogla, aftësimin profesional dhe trajnimin gjuhësor për fëmijët.

3. BLOKU 1: SIGURIA E DOKUMENTEVE

Kosova ka plotësuar **tetë nga nëntë kërkesat** në fushën e sigurisë së dokumenteve.

Karakteristikat e sigurisë së dokumenteve personale të udhëtimit, letërnjoftimet dhe dokumentet sekondare janë të kënaqshme. Këto dokumente janë në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe të BE-së mbi sigurinë e dokumenteve.

Sistemi i regjistrimit të gjendjes civile të Kosovës (SRGjC) është përmirësuar në masë të madhe. Puna e vazhdueshme ka për qëllim krijimin e një bazë të vetme qendrore të të dhënave që bashkon të dhënat nga bazat ekzistuese të të dhënave, ndërsa verifikon integritetin dhe cilësinë e të dhënave themelore. Me anë të trajnimit të duhur, është prezantuar një version i ri i SRGjC-së në korrik të vitit 2015, i cili kërkon verifikim të fuqishëm sa herë që lëshohet një certifikatë e re e gjendjes civile.

Qytetarëve iu lëshohet një Numër unik Identifikues Personal, i lidhur me të dhënat e tyre biometrike, kur kërkojnë një dokument të gjendjes civile. Kjo metodë i ka lejuar Agjencisë së Regjistrimit Civil që të verifikoj të dhënat personale të 1,602,453 qytetarëve, ose 86% të popullsisë.

Në vitin 2014, Agjencia për Regjistrim Civil ka nënshkruar Memorandume të Mirëkuptimit me Këshillin Prokurorial të Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Njësinë e Inteligjencës Financiare, Administratën Tatimore dhe Doganat e Kosovës për të siguruar ndërveprimin ndërmjet bazave të tyre përkatëse të të dhënave. Shumica e këtyre bazave të të dhënave tashmë janë ndërlidhur.

Ndryshimi i emrave dhe mbiemrave rregullohet me aktet nënligjore të miratuara në maj të vitit 2015 dhe ndryshuar në nëntor të vitit 2015. Subjekt ndaj kontrollimit të historikut kriminal dhe caktimit se aplikuesi nuk është nën hetime kriminale, kërkesat duhet të

aprovohen nga policia dhe gjyqësori dhe kjo mund të bëhet një herë në pesë vite. Ndryshimet e miratuara në nëntor të vitit 2015 kanë themeluar një komitet të veçantë në Agjencinë e Regjistrimit Civil për verifikimin e kërkesave për ndryshimet e emrave në bazë të ekstrakteve nga SRGJC-ja. Në të ardhmen, ky Komitet pritet të këshillojë komunat lokale nëse duhet të aprovojnë kërkesat. Kjo pjesë e ndryshuar e legjislacionit duhet të zbatohet tani plotësisht.

Rekomandimi Nr. 2:

- Në mënyrë që të përmbushë kërkesat në fushën e sigurisë së dokumenteve, Kosova duhet të demonstroj që ka zbatuar legjislacionin e saj të ndryshuar mbi ndryshimet e emrave.

4. BLOKU 2: MENAXHIMI I KUFIRIT/KUFIRIT ADMINISTRATIV DHE MIGRACIONIT

4.1 Menaxhimi i kufirit/kufirit administrativ

Kosova ka plotësuar **katërmbëdhjetë nga pesëmbëdhjetë kërkesat** në fushën e menaxhimit të kufirit/kufirit administrativ, duke përfshirë përgjegjësitë e transportuesve.

Legjislacioni i Kosovës është në mase të madhe në përputhje me *acquis* të Shengenit, dhe kontrollet kryhen në përputhje me standardet e BE-së. Pikë-kalimet kufitare / e kufirit administrativ janë të pajisura në mënyrë të mjaftueshme për të kryer kontrollet e linjës së parë dhe të dytë, me përjashtim të pikë-kalimit në Merdarë, ku pika e përhershme e kalimit të MIK-ut është duke u vendosur. Në përputhje me rekomandimet e misionit të ekspertëve në korrik të vitit 2015, autoritetet e Kosovës ri-vendosen në mes të nëntorit 2015 kontrollimet dalëse në pikën kryesore kufitare /kufirit administrativ me Shqipërinë.

Autoritetet relevante kanë personel të duhur për kontrollin e flukseve të trafikut dhe lëvizjet e pasagjerëve. Ato janë të pajisura në mënyrë të mjaftueshme për mbikëqyrjen e kufirit; vlerësimi i rrezikut përdoret për të monitoruar zonat me rrezik të lartë, por zbulimi mbetet i ulët. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka qasje në internet.

Qendra e MIK-ut në Kosovë është plotësisht operative. Ajo përbëhet nga një personel nga të gjitha autoritetet relevante dhe është përgjegjëse për vlerësimin strategjik dhe operativ të rrezikut në nivel qendror, shkëmbimin e informacioneve dhe mbrojtjen e të dhënave. Në nivel lokal, vlerësimi i rrezikut kryhet në pikë-kalime kufitare.

Është përmirësuar bashkëpunimi me vendet fqinje. Marrëveshja për demarkacionin e kufirit/kufirit administrativ me Malin e Zi duhet të ratifikohet nga Kosova para se të bëhet liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës.

Bashkëpunimi i Kosovës me FRONTEX është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme. Të gjitha autoritetet relevante janë të vetëdijshme mbi situatën në lidhje me krimet e ndërlidhura me kufi/kufi administrativ, edhe pse numri i rasteve të zbuluara dhe të hetuara të migrimit të lehtësuar të parregullt, trafikimit me qenie njerëzore dhe trafikimin e narkotikeve mbetet i ulët.

Rekomandimi Nr. 3:

- Për të qenë plotësisht në pajtueshmëri me kërkesat në fushën e menaxhimit të kufirit/kufirit administrativ, Kosova duhet të ratifikojë marrëveshjen për demarkacionin e kufirit/kufirit administrativ me Malin e Zi para dhënies së liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës.

4.2 Menaxhimi i migracionit

Kosova ka plotësuar **të gjitha dhjetë kërkesat** në fushën e menaxhimit të migracionit.

Legjislacioni i Kosovës në fushën e menaxhimit të migracionit është në harmoni me *acquis* të BE-së. Sistemi Informativ i Vizave të Kosovës (SIVK) është vendosur në 15 nga 30 misionet diplomatike apo konsullore të Kosovës jashtë vendit. 15 misionet e mbetura që nuk janë lidhur me SIVK-në janë të vendosura në Shtetet Anëtare të BE-së apo Shtetet Anëtare të Zonës Shengen ku së paku një konsullatë, zakonisht në kryeqytet, tashmë është lidhur me këtë sistem. Për shkak të përfaqësimit të kufizuar diplomatik të Kosovës në botë, SIVK është në dispozicion vetëm në disa kryeqytete amerikane, afrikane apo aziatike. Për të vënë këtë sistem në dispozicion për të gjithë shtetasit e vendeve të treta të cilët kërkojnë viza për të hyrë në Kosovë,⁶ autoritetet Kosovare kanë filluar të kontraktojnë aplikacionet për viza tek ofruesit e shërbimeve të jashtëm përderisa mbajnë kontrollin mbi vendimet për viza. Ky proces duhet të vazhdojë.

Në përputhje me Kodin e Kufijve të Shengen, vizat jepen vetëm në kufijtë e Kosovës në rrethana të jashtëzakonshme.⁷

Profili i zgjeruar i migrimit të Kosovës është i zhvilluar mirë. Ajo mund të rafinohet më tutje duke përfshirë informacion në lidhje me diasporën e Kosovës.

Në vitin 2014, Kosova ka lëshuar 77 leje qëndrimi për të huajt. Pasi që integrimi i të huajve është ende në fillimet e saj, Kosova duhet të fus në këtë fushë përvojën që ka marrë në drejtimin e programit të saj për riintegrim.

Kosova operon objektet e saja të paraburgimit—objektin e përkohshëm në aeroportin e Prishtinës dhe objektin e përhershëm në Vranidoll—në përputhje me Direktivën e Kthimit të BE-së. Të kthyerit gëzojnë masa mbrojtëse procedurale adekuate dhe qasje në shërbime, siç kërkohet nga Direktiva për Kthim. Një fletëpalosje që përshkruan masat mbrojtëse procedurale për të kthyerit duhet të vihet në dispozicion në të dy objektet.

Bazat e ndryshme të të dhënave në fushën e zbatimit të ligjit dhe migrimit aktualisht janë duke u ndërlidhur.⁸

4.3 Azili

Kosova ka plotësuar **gjashtë nga shtatë kërkesat** në fushën e azilit.

Legjislacioni i Kosovës është në harmoni me *acquis* e BE-së dhe ka strukturën dhe burimet e nevojshme institucionale për të ofruar mbrojtje ndërkombëtare për azilkërkuuesit.

Sipas UNHCR, 62 dhe 98 persona kanë kërkuar azil në Kosovë, përkatësisht në vitin 2013 dhe 2014—katër aplikantë kanë pranuar mbrojtje plotësuese në vitin 2013; një në vitin 2014. Përderisa rruga e migrimit e Ballkanit Perëndimor deri më tani e ka anashkaluar, Kosova duhet t'i vë në përdorim objektet e saj për t'i dhënë mbrojtje ndërkombëtare atyre që e meritojnë.

Kosova ka përmirësuar bashkëpunimin e saj me UNHCR-in në vitin 2015, veçanërisht në

⁶ Qytetarët e 88 vendeve kërkojnë viza për të hyrë në Kosovë. Qytetarët e Shteteve Anëtare të BE-së dhe Shteteve Anëtare të Zonës Shengen janë të përjashtuar nga kërkesa për vizë. Shtetasit e vendeve të treta që kërkojnë vizë për të hyrë në Kosovë mund ta bëjnë këtë për pesëmbëdhjetë ditë nëse kanë vizë Schengen me shumë hyrje. Këto dispozita zbatohen edhe për personat që bartin dokumente të udhëtimit për refugjatët dhe personat pa shtetësi

⁷ Ndërmjet tetorit të vitit 2014 dhe tetorit të vitit 2015, vetëm 8 viza janë lëshuar në pikëkalimet e kufirit/kufirit administrativ të Kosovës

⁸ Këto sisteme përfshijnë si në vijim: Sistemin për Menaxhimin e Kufirit (SMK), Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK), Sistemin për Informata për Vizat e Kosovës (SIVK), Sistemin e Regjistrimit të Gjendjes Civile (SRGJC) dhe Sistemin për Menaxhimin e Rasteve për të kthyerit, si dhe bazën e të dhënave për azil dhe migracion

fushën e përkthimit në distancë. Ajo ka hartuar listën e saj të përkthyesve dhe ka lidhur një marrëveshje me UNHCR-në për të shfrytëzuar burimet e saj të përkthimit nga distanca për gjuhët që Kosova nuk i mbulon.

Rekomandimi Nr. 4:

- Në mënyrë që të plotësohen kërkesat në fushën e azilit, Kosova duhet të monitorojë arsyet për shkallën e saj të ulët të njohjeve për azilkërkuesit.

5. BLOKU 3: RENDI PUBLIK DHE SIGURIA

5.1 Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit

Kosova ka plotësuar **dymbëdhjetë nga pesëmbëdhjetë kërkesat** në fushën e luftimit të krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit.

Në qershor të vitit 2015, Kuvendi ka miratuar ndryshimet për katër ligjet⁹ kryesore që mbështesin sistemin e të drejtës penale të Kosovës. Këto ndryshime kanë harmonizuar kriteret për emërimin e gjykatësve dhe shkarkimin e gjykatësve dhe prokurorëve, përforcimin e pavarësisë së tyre duke iu dhënë atyre kompetenca për propozimin e buxheteve të tyre. Vendet e lira të punës aktualisht janë duke u plotësuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK).¹⁰

Në tetor të vitit 2015, KGJK-ja ka transferuar tre gjykatës në departamentin e krimeve të rënda të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke arritur numrin e përgjithshëm të gjykatësve në 14. Ky zhvillim i mirëpritur duhet të zgjerohet në të gjitha departamentet e krimeve të rënda në gjykatat në Kosovë. Nxitja e mëtejshme e burimeve njerëzore të departamenteve të krimeve të rënda të gjykatave themelore, përfshirë personelin e kualifikuar dhe personelin mbështetës me buxhet të duhur, duhet të bëhet prioritet për Kosovën.

Në vitin 2014, KGJK-ja ka miratuar strategjinë për zvogëlimin e rasteve të grumbulluara në gjykata, e cila synon që deri në fund të vitit 2016, përmbarimin e shumicës së vendimeve në konteste administrative.¹¹ KGJK-ja duhet tani të prioritetizojë burimet e pakta në atë mënyrë që gjykatësit në departamentet e krimeve të rënda, me personelin e duhur mbështetës, mund të fokusohen në gjykimin e rasteve të rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Regjistri i hetimeve i Kosovës në gjykimin e rasteve të rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit mbetet i dobët, pjesërisht për shkak të problemeve me kapacitete që ndikojnë në gjyqësor.¹² Për ta përmirësuar këtë gjendje, kryeprokurori ka emëruar në tetor të vitit 2015 ushtruesin e detyrës së udhëheqësit të prokurorisë speciale si koordinator qendror për të përzgjedhur dhe shënjestruar rastet e rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kosova tani duhet të marrë parasysh dhënien e mandatit dhe burime për zyrën e koordinatorit qendror për të udhëhequr ekipet multi-disiplinore, të përbëra nga prokurorët special, zyrtaret policor, zyrtarët e doganave dhe zyrtarët tatimor, për kryerjen e hetimeve financiare dhe monitorimin

⁹ Ligji mbi Gjykatat, Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji për Prokurorin

¹⁰ Nga 171 pozitive në prokurori, KPK ka plotësuar 157 poste. Aktualisht është duke u bërë thirrja për rekrutimin e 15 prokurorëve nga minoritetet

¹¹ Nga 102,009 rastet që kanë përbërë rastet e grumbulluara në dhjetor të vitit 2011, gjykatat e Kosovës kanë arritur të zbatojnë 25,275 raste të vjetruara (apo afërsisht 25 % të rasteve të grumbulluara) në vitin 2014. Shumica e këtyre kanë kërkuar zbatimin e vendimeve në lidhje me pagesën e faturave të shërbimeve komunale. KGJK-ja planifikon zvogëlimin e mëtejshëm të rasteve të grumbulluara të zbatimit deri në vitin 2016, kryesisht nëpërmjet zgjidhjes alternative të kontestit

¹² Prokuroria ka paraqitur akuza të ndërlidhura me krimin e organizuar në raste në vitin 2013; 8 raste në vitin 2014; dhe 3 raste në gjysmën e parë të vitit 2015. Ata kanë paraqitur akuza në 314 raste të korrupsionit në vitin 2013; 444 raste në vitin 2014; dhe 128 raste në gjysmën e parë të vitit 2015. Nuk ka të dhëna në lidhje me dënimet përfundimtare në këto raste.

e përcjelljes gjyqësore të rasteve të rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë ngrirjen dhe konfiskimin e aseteve, zbatimin e urdhrave për konfiskim dhe kthimin e aseteve të fituara në mënyrë të paligjshme tek shoqëria.

Kosova është duke punuar në zhvillimin e një sistemi për menaxhimin e integruar të rasteve që lejon përcjelljen e rasteve nga faza e inteligjencës dhe hetuese, nëpërmjet ndjekjes penale dhe dënimeve përfundimtare për rikuperimin e aseteve. Zyra e koordinatorit qendror që është përgjegjëse për rastet e rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit duhet të ndërmarrë hapa për të ri-fuqizuar lidhjet operationale dhe të TI-së ndërmjet zbatimit të ligjit dhe ndjekjes penale. Është duke u zhvilluar puna përgatitore.

Strategjia qeveritare e vitit 2014 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është zbatuar, por dënimet në lidhje me pastrimin e parave mbesin të ulëta.

Kosova ka bërë progres në ngrirjen dhe konfiskimin e aseteve të fituara në mënyrë të paligjshme, por vetëm një pjesë e vogël e aseteve të tilla është konfiskuar.¹³ Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të urdhrave për konfiskim, Agjencia për Administrimin e Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAASK) është e detyruar t'i administrojë për kohe të pacaktuar asetet e sekuestruara nga zbatimi i ligjit. Ligji i vitit 2013 mbi kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e aseteve duhet të përdoret plotësisht.

Kosova, në vitin 2015 ka forcuar në mënyrë të konsiderueshme policimin e udhëhequr nga inteligjenca, e cila duhet të jetë e qëndrueshme. Policia e Kosovës ka qasje në një varg të bazave të të dhënave që janë të nevojshme për punën e saj.

Është në vazhdim e sipër puna për krijimin e bazës elektronike të të dhënave, por të dhënat duhet akoma të futen plotësisht në sistem.

Prokurimi publik mbetet burim kryesor i korrupsionit në Kosovë. Kuvendi ka miratuar një ligj të ndryshuar mbi prokurimin publik më 14 dhjetor 2015, i cili përveç çështjeve tjera ka krijuar një platformë për prokurimin elektronik dhe synon të rregullojë statusin e anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, i cili menaxhon prokurimin publik në Kosovë dhe Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHPP), i cili shqyrton vendimet e marra nga Komisioni. Këto ndryshime pritet të hyjnë në fuqi në janar të vitit 2016. Me pretendimet për kolizion ndërmjet OSHPP-së dhe gjyqësorit, si dhe pretendimet korruptive kundrejt udhëheqësit të OSHPP-së, është e rëndësishme që Kosova të vendos masa të duhura mbrojtëse për të garantuar pavarësinë funksionale të OSHPP-së. Duhet të zbatohen plane strikte të integritetit për mbrojtjen e pavarësisë së të dyja organeve.

Agjencioni Kundër Korrupsion dhe Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit, të udhëhequr nga Presidentja e Kosovës, kanë përmirësuar bashkëpunimin mes tyre. Agjencioni Kundër Korrupsion është pajisur në mënyrë të duhur me burime dhe vazhdon të shqyrtojë deklaratimet e pasurive dhe të monitoroj konfliktet e interesit në sektorin publik.

Ligji i Kosovës për financimin e partive politike është vënë në përdorim gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2014. Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) tani ka personel të mjaftueshëm. Gjatë fushatës së vitit të kaluar, të gjitha partitë politike kanë dorëzuar në KQZ raportet e tyre financiare, ku disa kanë marrë gjoba për dorëzimin me vonesë të raporteve të tyre.

Ligji i Kosovës për Përgjime është miratuar në maj të vitit 2015. Ai bën ndarjen e qartë, nga pikëpamja ligjore, procedurale dhe teknike, ndërmjet përgjimit të ligjshëm për qëllime të së drejtës penale dhe mbrojtjes së sigurisë së Kosovës. Kjo pjesë e legjislacionit gjithashtu

¹³ Në vitin 2014, asetet në vlerë 30 milionë Euro ishin ngrirë apo sekuestruar, por vetëm 128,000 janë konfiskuar. Në gjysmën e parë të vitit 2015, 27,000 Euro janë konfiskuar nga asetet në vlerë 16 milionë Euro sipas urdhrat për ngrirje apo sekuestrim.

rregullon ruajtjen e të dhënave. Është duke u bërë zbatimi i kësaj pjese të rëndësishme të legjislacionit.

Mbrojtja e dëshmitarëve tanimë është funksionale në Kosovë. Drejtoria për mbrojtjen e dëshmitarëve e policisë është e plotësuar me personel në mënyrë të duhur, me një buxhet të duhur. Është arritur një numër i marrëveshjeve për ri-vendosje me vendet e treta.

Kosova ka arritur progres në luftimin e trafikimit të narkotikëve. Ka konfiskuar sasi të shtuar të marihuanës, heroinës dhe kokainës në vitin 2013 dhe 2014. Kosova ka arritur një sërë memorandumesh të mirëkuptimit me partnerët kryesorë dhe merr pjesë nëpërmjet Njësisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit, (ILECU), në “Rrugën e Ballkanit Perëndimor” dhe “Ekipin e Përbashkët Hetimor në Ballkan” të udhëhequr nga Evropa kundër trafikimit të narkotikëve. Shumica e rasteve të krimeve të organizuara të hetuara nga policia kanë të bëjnë me trafikimin e narkotikëve, edhe nëse dënimet përfundimtare në rastet e ndërlidhura me trafikimin e narkotikëve mbesin të ulëta.

Përgjigja e Kosovës ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandimit të emigrantëve është e pranueshme. Policia ka një numër të mjaftueshëm të personelit për të hetuar krimet që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimit të emigrantëve. Pas krizës së jashtëzakonshme të migrimit nga Kosova, në fund të vitit 2014 dhe fillim të vitit 2015, Kosova ka shtuar kontrollin e kompanive të autobusëve që zakonisht kanë lehtësuar kontrabandimin e emigrantëve. Përderisa, rruga e migrimit të Ballkanit Perëndimor deri tani ka anashkaluar Kosovën, ajo ka forcuar bashkëpunimin për zbatimin e ligjit me Serbinë, Hungarinë dhe Austrinë.

Ligji për kompensimin e viktimave të krimit është duke u zbatuar dhe Kosova ka shtuar përpjekjet e saja për rehabilitimin e viktimave dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore.

Kosova është duke adresuar trafikimin e armëve, por shkalla e shkatërrimit të armëve të vogla mbetet e ulët. Në mënyrë që të rritet efikasiteti i përpjekjeve të saj kundër trafikimit të armëve të zjarrit, Kosova duhet t'i jap prioritet zbatimit të të gjitha veprimeve të dakorduara në Planin e Veprimit mbi trafikimin e paligjshëm të armëve të zjarrit ndërmjet BE-së dhe Rajonit të Evropës Juglindor.

Përpjekja e Kosovës kundër terrorizmit mbeten funksionale. Luftëtarët e huaj mbesin një shqetësim, ndërsa autoritetet Kosovare kanë mbledhur informacione të mjaftueshme në lidhje me luftëtarët kosovarë në Siri. Është duke u zbatuar ligji i vitit 2015 mbi ndalimin e pjesëmarrjes në konflikte të armatosura. Qeveria ka shtuar në mënyrë të konsiderueshme përpjekjet e saj për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin në Kosovë, veçanërisht përmes marrjes së mbështetjes nga liderët Islamik.

Rekomandimet nr. 5, 6 dhe 7:

Për të qenë plotësisht në pajtueshmëri me kërkesat në fushën e luftimit të krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit, Kosova duhet të veprojë si në vijim:

- Të transferoj një numër të mjaftueshëm të gjykatësve, me personelin e duhur mbështetës, në departamentet e krimeve të rënda në të gjitha gjykatat në Kosovë;
- Të krijojë një regjistër të hetimeve, aktgjykimeve finale në rastet e rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përkatësisht përmes dhënies së mandatit dhe burimeve për rastet e rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit tek koordinatori qendror për udhëheqjen e ekipeve multi-disiplinore të hetimeve financiare dhe për monitorimin e përcjelljes gjyqësore të rasteve të tilla;

- Të sigurojë pavarësinë funksionale të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik. Duhet të zbatohen plane strikte të integritetit për të mbrojtur pavarësinë e këtij organi dhe të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

5.2 Bashkëpunimi në fushën e zbatimit të ligjit

Kosova ka plotësuar **të gjitha njëmbëdhjetë kërkesat** në fushën e bashkëpunimit për zbatimin e ligjit.

Kosova ka nënshkruar 55 memorandume të mirëkuptimit mbi bashkëpunimin në fushën e zbatimit të ligjit me 16 vende dhe EULEX-in. Ajo ka dërguar 7 zyrtarë ndërlidhës tek partnerët kryesorë, siç është Turqia, Gjermania, Austria dhe Franca.

Bashkëpunimi në fushën e zbatimit të ligjit zhvillohet qoftë në baza bilaterale, apo në lidhje me Evropën nëpërmjet EULEX-it, apo në lidhje me Interpol-in nëpërmjet pikës së kontaktit të vendosur në Misionin e Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Këto dy të fundit lehtësojnë edhe shkëmbimin e informacioneve në fushën e zbatimit të ligjit me Serbinë.

Marrëdhëniet me Europol-in nëpërmjet EULEX-it janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme dhe në këtë mënyrë edhe bashkëpunimi me Interpol-in nëpërmjet pikës së kontaktit me UNMIK-un. Në gusht të vitit 2015, Kosova ka dorëzuar aplikacionin për t'iu bashkangjitur Interpol-it.

Policia e Kosovës ka qasje në seminarët e organizuara nga Kolegji i Policisë Evropiane (CEPOL).

5.3 Bashkëpunimi gjyqësor për çështje penale

Kosova ka plotësuar **të gjitha shtatë kërkesat** në fushën e bashkëpunimit gjyqësor për çështjet penale.

Autoriteti i duhur është plotësuar me personel të mjaftueshëm për trajtimin e kërkesave hyrëse dhe dalëse për ndihmë reciproke juridike.

Kosova ka nënshkruar dy marrëveshjeve të ndihmës reciproke juridike me Belgjikën, Kroacinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Gjermaninë, Italinë, Zvicrën dhe Shtetet e Bashkuara. Bashkëpunimi me Serbinë, nëpërmjet Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian (PSBE), është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme.

Bashkëpunimi gjyqësorë në çështjet penale funksionon me Shtetet Anëtare të BE-së qoftë nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale apo PSBE-së.

Kosova gjithashtu ka eksploruar mundësitë e bashkëpunimit me Eurojust.

5.4 Mbrojtja e të dhënave

Kosova ka plotësuar **të gjitha tri kërkesat** në fushën e mbrojtjes së të dhënave.

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale është në harmoni me *acquis* të BE-së, edhe pse ndryshimet e ardhshme në kornizën e BE-së për mbrojtjen e të dhënave duhet të integrohen në strukturën ligjore të Kosovës. Agjencia për mbrojtjen e të dhënave ka miratuar legjislacionin sekondar mbi sigurinë e të dhënave.

Kjo agjenci tani konsultohet në mënyrë sistematike mbi projektligjet e dërguara në Kuvend—kompetencë që e ka përdorur për të ndikuar në përmbajtjen e disa pjesëve të draft legjislacionit.

Agjencia gjithashtu ka organizuar një sërë aktivitetesh vetëdijësuese dhe tani janë caktuar

zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave në nivel lokal. Buxheti i Agjencisë duhet të ruhet.

6. BLOKU 4: TË DREJTAT THEMELORE LIDHUR ME LIRINË E LËVIZJES

Kosova ka plotësuar **shtatë nga tetë kërkesat** në fushën e të drejtave themelore lidhur me lirinë e lëvizjes.

Korniza e të drejtave themelore mbetet e qëndrueshme dhe është fuqizuar me miratimin e ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, ligjit për barazinë gjinore dhe ligjit për avokatin e popullit në maj të vitit 2015. Ligjet janë miratuar si një pako e vetme legislative (Pakoja e Ligjeve për të Drejtat e Njeriut) dhe ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2015.

Ligji për mbrojtje nga diskriminimi përfshinë dispozitat për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, promovimin e barazisë efektive dhe funksionalizimin e parimit të trajtimit të barabartë të të gjithë personave para ligjit. Ligji për barazi gjinore siguron respektim të plotë të të drejtave të grave në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ligji i ri për avokatin e popullit ka përmirësuar legjislacionin mbi institucionin e avokatit të popullit, duke zgjeruar mandatin e tij dhe duke i fuqizuar dispozitat mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e tij. Për zbatimin e këtyre ligjeve kërkohet miratimi i tetë akteve nënligjore deri në fund të vitit 2015.

Zbatimi i Ligjit të Avokatit të Popullit duhet të rrisë në veçanti kapacitetet dhe burimet e institucionit për tu marrë me mandatin e tij të zgjeruar. Si organi kryesor i vendit për trajtim të barabartë dhe mekanizëm kombëtar për parandalim, ai ka nevojë për më shumë personel, objekte të duhura dhe buxhet të duhur për përmbushjen e rolit të tij të ri. Masat fillestare të ndërmarra nga qeveria janë në kundërshtim me frymën e ligjit të ri. Qeveria duhet të ndajë objekte të duhura dhe të sigurojë pavarësinë e plotë buxhetore të avokatit të popullit.

Zyrat rajonale të avokatëve të popullit sigurojnë që qytetarët të kenë qasje në informacione mbi mandatin dhe detyrat e tij.

Qeveria po ashtu ka vazhduar zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas. Financim i mëtijshëm është alokuar dhe shpenzuar në nivel lokal, për të përfituar ndërmarrje të ndryshme që kanë synuar minoritetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas.

Zbatimi strikt i nenit 147 të kodit penal nuk do të mbulojë të gjitha incidentet me motive etnike, meqë ky nen nuk mbulon synimet e krimit. Përdorimi ekskluziv i këtij neni do të nënkuptojë që regjistrimi i incidenteve mund të mos marrë parasysh motivimin e tyre të mundshëm etnik. Ky boshllëk do të mund të adresohet përmes zbatimit të nenit 74.2.12 të kodit penal, i cili merr parasysh nëse krimi është i motivuar etnikisht.

Në vitin 2014, Policia e Kosovës ka regjistruar 19 raste me motive të mundshme etnike. Në tremujorin e fundit të vitit 2014 janë raportuar 26 raste me motive të mundshme etnike. Mekanizmi i përcjelljes është operativ që nga viti 2014. Megjithatë, numri i rasteve të krimeve me motive të mundshme etnike mbetet i paqartë, pasi që statistikat nuk mblidhen në një mënyrë të harmonizuar nga policia e Kosovës.

Tani kanë hyrë në funksion rregulloret që e bëjnë të mundur shmangien e mbivendosjeve ndërmjet mandateve të këshillave komunalë për sigurinë e komunitetit dhe kuvendeve komunale. Manuali për këshillat është publikuar në janar të vitit 2015.

Rekomandimi Nr. 8:

- Në mënyrë që të përmbushë plotësisht kërkesat në fushën e të drejtave themelore të lidhura me lirinë e lëvizjes, Kosova duhet të ofrojë objekte të duhura dhe të sigurojë pavarësinë e plotë buxhetore të avokatit të popullit.

7. PËRFUNDIMI

Komisioni ka vlerësuar zbatimin e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave nga Kosova në bazë të këtyre informacioneve dhe dokumenteve përkatëse legjislative dhe të politikave të ofruara nga Kosova. Ky vlerësim është plotësuar me misione vlerësuese në terren të realizuara nga Komisioni Evropian dhe të asistuar nga ekspertët nga Shtetet Anëtare të BE-së.

Që nga fillimi i dialogut për liberalizimin e vizave me Kosovën në janar të vitit 2012 dhe dorëzimit tek autoritetet Kosovare të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave në qershor të vitit 2012, Komisioni ka raportuar rregullisht tek Këshilli dhe Shtetet Anëtare, si dhe tek Parlamenti Evropian mbi progresin e arritur nga Kosova në plotësimin e kërkesave të udhërrëfyesit.

Dialogu për liberalizimin e vizave, si pjesë e politikës së përgjithshme të BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor, është zhvilluar brenda kornizës së Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit. Komisioni ka organizuar katër Takime me Zyrtarë të Lartë që nga viti 2012 dhe ka thirrur disa takime teknike në nivel të ekspertëve. Progresi mbi çështjet e mbuluara nga dialogu për liberalizimin e vizave është diskutuar dhe raportuar rregullisht në kuadër të kornizës së Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit.

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX KOSOVË), në përputhje me mandatin e tij, ka luajtur një rol të rëndësishëm në monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e institucioneve të Kosovës në miratimin dhe zbatimin e reformave dhe përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në udhërrëfyesin për viza. Autoritetet Kosovare po ashtu kanë treguar një bashkëpunim efikas me EULEX-in, duke përfshirë ushtrimin e mandatit të tij ekzekutiv.

Dialogu për viza me Kosovën ka dëshmuar të jetë një mjet i rëndësishëm dhe veçanërisht efikas në **avancimin e reformave me shtrirje të gjerë dhe reformave të vështira në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme** dhe përtej, duke ndikuar në fushat si reformat në fushën e sundimit të ligjit dhe në të drejtën penale. Këto çështje po ashtu monitorohen edhe përmes kornizave tjera, si nën-komiteti për Drejtësi, Liri dhe Siguri i Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit.

Progresi i arritur nga Kosova në të gjitha fushat e mbuluara nga udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave është i qëndrueshëm dhe efikas. Ai demonstroi angazhimin afatgjatë të institucioneve të Kosovës në përmbushjen e kërkesave që dalin nga udhërrëfyesi për viza si një çështje me prioritet të jashtëzakonshëm.

Komisioni tashmë ka prezantuar dy raporte gjithëpërfshirëse mbi progresin e Kosovës në përmbushjen e kërkesave që dalin nga udhërrëfyesi për viza. Raporti i parë, i miratuar në shkurt të vitit 2013, është fokusuar në pajtueshmërinë legjislative të Kosovës me kërkesat e udhërrëfyesit. Raporti i dytë, i publikuar në korrik të vitit 2014, është fokusuar në zbatim. Raporti i fundit ka formuluar 52 rekomandime përgjatë katër blloqeve të udhërrëfyesit të vizave, si dhe ri-pranimin dhe ri-integrimin. Ai ka theksuar se Kosova ka bërë progres të mirë në zbatimin e kërkesave të udhërrëfyesit të vizave, por kërkohen akoma përpjekje të mëtejshme në harmoni me këto rekomandime.

Raporti aktual ka përcaktuar 8 rekomandime që korrespondojnë me 8 kërkesat që nuk janë përmbushur, të cilat dalin nga udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave.

Progresi në zbatimin e reformave në fushat në vijim mbetet një prioritet kyç:

- Transferimi i një numri të mjaftueshëm të gjykatësve, me personel të duhur mbështetës, në departamentet për krime të rënda në gjykata në Kosovë;

- Krijimi i një regjistri të hetimeve, aktgjykimet finale dhe konfiskimeve në rastet e rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit, veçanërisht përmes dhënies së mandatit dhe burimeve për rastet e rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit tek koordinatori qendror për udhëheqjen e ekipeve multi-disiplinore të hetimeve financiare dhe gjithashtu për të monitoruar përcjelljen gjyqësore të rasteve të tilla;
- Sigurimi i pavarësisë operationale të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe zbatimi i planeve strikte të integritetit për mbrojtjen e pavarësisë së këtij organi dhe Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
- Demonstrimi se Kosova ka zbatuar legjislacionin e saj të ndryshuar sekondar mbi ndryshimin e emrit.

Komisioni do të vazhdojë të monitorojë progresin e Kosovës në përmbushjen e kërkesave tjera që nuk janë përmbushur dhe zbatimin e reformave të vazhdueshme në fushat në vijim: ratifikimin e marrëveshjes për demarkacionin e kufirit/kufirit administrativ me Malin e Zi para liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës; disbursimi i Fondit të Ri-integrimit me fokus në ofrimin e asistencës me punësim, themelimin e bizneseve të vogla, trajnimin profesional dhe trajnimin gjuhësor për fëmijët; monitorimin e arsyeve për shkallën e ulët të njohjeve për azilkërkuessit nga ana e Kosovës; dhe ofrimin e objekteve të duhura dhe sigurimin e pavarësisë së plotë buxhetore të avokatit të popullit.

Komisioni do të vazhdojë të monitorojë në mënyrë aktive zbatimin e vazhdueshëm nga Kosova të kërkesave të përcaktuara në katër blloqet që dalin nga udhërrëfyesi për viza, si dhe ri-integrimin dhe ri-pranimin, në kuadër të Dialogut ekzistues të Procesit të Stabilizim-Asociimit dhe nëse është e nevojshme, nëpërmjet mekanizmave përcjellës *ad hoc*.

Bazuar në këtë vlerësim dhe duke pasur parasysh rezultatin e monitorimit dhe raportimit të vazhdueshëm të kryer që nga fillimi i dialogut për liberalizimin e vizave me Kosovën në janar të vitit 2012, Komisioni e konsideron këtë raport si përfundimtar.

Mbesin rekomandimet e mësipërme; sapo të zbatohen dhe me kusht që ekzistojnë masa efikase dhe mbesin në fuqi për parandalimin e krizës së re të migrimit, Komisioni do të vazhdojë me lëshimin e propozimit që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 539/2001.

Kosova duhet të vazhdojë të organizojë fushatat e synuara informuese që kanë për qëllim sqarimin e të drejtave dhe obligimeve për udhëtim pa viza në zonën Shengen si dhe rregullat që rregullojnë qasjen në tregun e punës së BE-së. Komisioni do të vazhdojë të monitorojë dhe të bëjë maksimumin për mbështetjen e Kosovës në plotësimin e kërkesave që dalin nga liberalizimi i vizave.